



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

PA1 Nr.08-35

28.1.2026

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20; nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, 193/24 dhe 247/25), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ark.nr.01-3632/1 datë 22.8.2025, neni 24, paragrafi (5) të Rregullores së Procedurave të Punës Financiare dhe Kontabilitetit të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ark.nr.01-6222/1 datë 12.12.2014, njoftimin nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, nr.ynë ark. 08-303/1 datë 23.1.2026, deklaratën për ndërprerjen e transmetimit të programit televiziv nga themeluesi/pronari i vetëm i SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, nr.UZP 596/2026 dhe Deklaratë nga drejtuesi i transmetuesit nr.UZP 597/2026, të dyja me datë 23.1.2026 dhe konkluzionin me nr.ark.02-321/2 datë 28.1.2026, Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e katërt, mbajtur më 28.1.2026 miratoi:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i transmetuesve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë dhe do të zbatohet pas pagesës së kryer të kompensimit të Lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-39 datë 7.9.2023 nga radiodifuzeri në pajtim me faturën e dhënë nga Agjencia vetëm për periudhën e punës, përkatësisht nga data 24.12.2025 deri më 23.1.2026.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, është posedues i lejes për transmetim televiziv, PA1 nr.08-39 datë 7.9.2023 (me periudhë vlefshmërie nga 24.12.2023 deri më 23.12.2026), për transmetim të programit nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel rajonal për zonën e rajonit D6 - Mali Vllaj (komuna e Ohrit, komuna e Strugës, komuna e Vevçanit dhe komuna e Debrçës), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm kryesisht argëtues, në gjuhën maqedonase.

Më datë 23.1.2026, SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP, në mënyrë elektronike, në adresën zyrtare e-mail (të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi njoftim (nr.ynë ark.08-303/1 datë 23.1.2026), se për shkak të gjendjes së pafavorshme financiare, SHTR TV M Arnaudov Mihajlo Ohër SHPKNJP nuk ishte

në gjendje të kryente pagesën sipas Faturës me nr.2025-100-0199 datë 24.12.2025 të kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv, për këtë arsye transmetuesi njoftoi se heqë dorë (anulon) lejen për transmetim televiziv, PA1 nr.08-39 datë 7.9.2023. Si shtojcë e njoftimit u dorëzua Deklaratë nga themeluesi/pronari i vetëm i SHTR TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP - Mihajllo Arnaudov (e noterizuar) UZP nr.596/2026 të datës 23.1.2026 dhe Deklaratë nga menaxherja e transmetuesit - Irena Arnaudova (e noterizuar) UZP nr.597/2026 të datës 23.1.2026, në të cilën themeluesi/pronari i vetëm dhe menaxheri i transmetuesit deklaruan se SHTR TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP që nga 23.1.2026 ka ndërprerë me transmetim të programit televiziv dhe se transmetuesi do të përmbushë detyrimet financiare ndaj Agjencisë, në lidhje me pagesën e kompensimit të Lejes për transmetim televiziv (PA1 nr.08-39 datë 7.9.2023), për periudhën e punës, për të cilën Agjencia do të japë faturë të re.

Konkretisht, pas miratimit të këtij Vendimi, në pajtim me nenin 24, paragrafi (5) të Rregullores së Procedurave të Punës Financiare dhe Kontabilitetit të Agjencisë, SHTR TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP, Agjencia do t'i japë faturë të re, e cila do t'i referohet vetëm periudhës së punës, përkatësisht nga data 24.12.2025 deri më 23.1.2026, ku fatura duhet të paguhet jo më vonë se 8 (tetë) ditë nga dita e dhënies. Fatura e dorëzuar paraprakisht me nr. 2025-100-0199 datë 24.12.2025 (nr.ynë ark.05-5557/1 datë 24.12.2025) për kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv të SHTR TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP, për periudhën nga 24.12.2025 deri më 23.12.2026, e dhënë nga Agjencia, do të anulohet.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAA), leja për transmetim televiziv ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe me deklaratën me shkrim ku poseduesi njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programit televiziv. Për ndalimin e vlefshmërisë së lejes për transmetim televiziv në bazë ligjore Këshilli nuk miraton vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i radiodifuzerëve nëse lejes i mbaron vlefshmëria sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi (2) të LSHMAAV).

Si rrjedhojë, dhe duke marrë parasysh nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, me dorëzimin e deklaratave me shkrim të lartpërmendura, si dhe me shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj Agjencisë për kompensim të lejes nga ana e transmetuesit, do të përmbushen kushtet ligjore për ndërprerjen e vlefshmërisë së lejes sipas fuqisë ligjore, pas së cilës Agjencia do ta fshijë transmetuesin TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP nga regjistri i transmetuesve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, nenin 24, paragrafi (5) të Rregullores së Procedurave të Punës Financiare dhe Kontabilitetit të Agjencisë, Njoftimin nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP, nr.ynë ark.08-303/1 datë 23.1.2026, Deklaratë për ndërprerjen e transmetimit të programit nga themeluesi/pronari i vetëm i SHTR TV M Arnaudov Mihajllo Ohër SHPKNJP, UZP nr.596/2026 dhe Deklaratë nga menaxheri i transmetuesit UZP nr.597/2026, të dyja të datës 23.1.2026 dhe konkluzionin ark.nr.02-321/2 datë 28.1.2026, është marrë aktvendim si në dispozitiv, që hyn në fuqi menjëherë, dhe do zbatohet pas pagesës së kryer të kompensimit të lejes në llogari të Agjencisë nga transmetuesi, në pajtim me pikën 3 të këtij aktvendimi.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

mr. Sasho Stefanovski

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.